

# STATUTI

## I SHOQËRISË “KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT” SHPK,

Në Tiranë, sot në datë 02.02.2018

**Ylber BEZO**, i biri Rexhepit i datëlindjes 05.11.1954, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, Rruga “Mine Peza”, P.147/A ap.8. Njësia Bashkiake Nr-9, nr. Letër njoftimi F41105087Q shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar,

**Nadire BEZO**, e bija e Qazimit, e datëlindjes 20.12.1954, lindur në Krujë dhe banuese në Tiranë, Rruga “Mine Peza”, P.147/A ap.8. Njësia Bashkiake Nr-9, nr Letër njoftimi F46220149D , shtetase shqiptare, madhore, me zotësi juridike dhe për të vepruar,

**Ardi BEZO**, i biri i Ylberit i datëlindjes 30.10.1983, lindur në Gramsh dhe banues në Tiranë, adresa Rruga “Mine Peza”, P.147/A ap.8. Njësia Bashkiake Nr-9, nr. Letër njoftimi I31030046J , shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar,

**Bledi BEZO**, i biri i Ylberit i datëlindjes 03.11.1987, lindur në Gramsh dhe banues në Tiranë, adresa Rruga “Mine Peza”, P.147/A ap.8. Njësia Bashkiake Nr-9, nr.Pasaporte I71103051J , shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar,

Me cilësinë e ortakëve kanë redaktuar këtë statuti, për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, “KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT” shpk. në respektim të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe Ligjit nr.974,1 datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe vendimit të Asamblese së Ortakëve nr.4 Datë 18.08.2014.

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 FORMA LIGJORE

Shoqëria është një person juridik Shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të Ligjit nr.9741 date 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka fituar lejen dhe ushtron veprimtari në fushën e edukimit, në arsimin e lartë, me VKM nr. 951 datë 14.09.2011” Për liçencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit”.

Shoqëria do të drejtojë aktivitetin tregtar dhe atë si institucion i arsimit të lartë, sipas Legjislacionit parësor dhe sekondar Shqiptar të fushave përkatëse dhe dispozitave të këtij statuti apo rregulloreve të tjera në zbatim të tij.

#### Neni 2 EMËRTIMI

Emri i shoqërisë është “KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT” ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa sh.p.k, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Emërtimi i shkurtuar i shoqërisë do të jetë “KUB”

Shoqëria “KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT” sh.pk. ka logon/stemën dhe vulën e saj, e cila aprovet nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë.



### **Neni 3**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT” sh.p.k. është:

Veprimtari në fushën e arsimit; parashkollor, 9- vjeçar, të mesem të përgjithshme, profesional dhe teknik, të lartë universitar, studime profesionale të larta deri një dhe dy vjeçare, pasuniversitar, kualifikime të vijueshme dhe trajnime; Shërbime Private të Sigurisë Fizike dhe Qënder trajnimi privat të punonjësve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike; shërbime të konsulencës dhe ndërmjetësit/agjencisë/zyrës, financiare, të sigurimeve, të letrave me vlere, fiskale, bankare, të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të auditimit, të pasurive të patundshme, të energjisë, kryerje studimesh dhe projektesh të çdo natyre dhe fushe, vetë dhe në bashkëpunim, apo me njësi të krijuar posaçërisht, që lidhen me zhvillimin ekonomik, financiar, politiko-social, ligjor, institucional, e edukimit, mjedisor, integrimin etj. Si dhe shërbime mbështetëse të tyre, që lidhen me prodhim, ndërtim, botime, tregëti, ushqim, bar restorante hoteleri, si dhe çdo aktivitet tjetër mbështetës dhe me karakter tregtar të lejuar me ligj.

### **Neni 4**

#### **SELIA**

Selia e qendrës së Shoqërisë do të jetë në qytetin e Tiranës në adresën: Rruga “ Vangjel Noti”, Nr. 25 pranë AMC Laprakë, Tiranë.

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, duke hapur filiale, degë apo zyra për veprimtari të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 5**

#### **KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Vendosja e mëposhme e një kufizimi në kohë është kompetencë e mbledhjes të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 6**

#### **REGJISTRIMI I KAPITALIT DHE ORTAKËT**

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë dhe është i ndarë në 100 (njëqind) pjesë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secila. Kapitali i shoqërisë është i ndarë ortakëve të shoqërisë si më poshtë:

1. Ortaku Ylber Bezo, zotërues i 40 kuotave, me vlerë të përgjithshme 40 000 lekë, të cilat përfaqësojnë 40% të kapitalit të shoqërisë,
2. Nadire Bezo, zotëruese e 10 kuotave, me vlerë të përgjithshme 10 000 lekë, të cilat përfaqësojnë 10% të kapitalit të shoqërisë,
3. Bledi Bezo, zotërues i 20 kuotave, me vlerë të përgjithshme 20 000 lekë, të cilat përfaqësojnë 20% të kapitalit të shoqërisë,
4. Ardë Bezo, zotërues i 30 kuotave, me vlerë të përgjithshme 30 000 lekë, të cilat përfaqësojnë 30% të kapitalit të shoqërisë.

### **Neni 7**

#### **ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo në të holla, siç parashikohet në ligj.



Rritja e kapitalit mund të realizohet me emetimin e kuotave të reja ose duke rritur vlerën e kuotave ekzistuese.

Rritja dhe Zvogëlimi i kapitalit do të kryhet me vendim të Mbledhjes së Asamblesë të Ortakëve të shoqërisë mbeshetur në një raport të përgatitur nga eksperti kontabël i regjistruar (i licencuar).

Mbledhja e asamblesë së ortakëve do të marrë vendim e bazuar mbi dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## **Neni 8** **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të Shoqërisë "KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT" janë:

- a. Asambleja e Ortakëve
- b. Bordi i Administrimit
- c. Administratori.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e secilit prej organeve të shoqërisë janë të parashikuara në këtë statut dhe në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## **Neni 9** **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

1. Të drejtat e ortakëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së ortakëve, e cila funksionon dhe merr vendime sipas dispozitave të Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

2. Asambleja e ortakëve merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin, revokimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin, revokimin e drejtuesve të shkollave dhe fakulteteve, kur kryhet veprimtari në fushën e edukimit;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
- k) Hapja dhe mbyllja e filialeve, degëve, zyrave dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit.
- l) Shitja e pjesëve të kapitalit.
- ll) të vendosë për krijimin e bashkëpunimeve të biznesit afatgjata dhe përcaktimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

3. Asambleja e ortakëve merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e administrimit dhe raportin e eksperteve kontabël të autorizuar.

4. Pavarësisht nëse shoqëria zotërohet nga një apo shume ortakë, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga çdo ortak. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve. Duhet regjistruar në veçanti, por pa t'u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) shitja e pjesëve të kapitalit;
- dh) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

### **Neni 10** **Bordi i Administrimit**

Bordi i Administrimit në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr administratorin për vënien në zbatim të politikave tregtare të shoqërisë dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Bordi i Administrimit përbëhet nga 3 deri në 7 anëtarë që caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Anëtarë të Bordit të Administrimit mund të caktohen, përveç investitorëve të kapitalit edhe përfaqësues të spikatur të botës akademike, të biznesit, të pushtetit publik. Në përbërje të tij vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, apo kufizime ligjore me këtë detyrë.

Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Bordit të Administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është:

- a) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikëqyrës në 2 shoqëri të tjera.
- b) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikëqyrës në një shoqëri tjetër që ushtron veprimtari në të njëjtën fushë.
- c) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;
- d) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë.

Për veprimtari në fushën e arsimit të lartë, në vënd të Bordit të Administrimit, të drejtat, detyrat dhe kompetencat, sipas ligjit të arsimit të lartë dha akteve nenligjore të tij, i ushtron Senati Akademik.

Mandati i anëtarëve të Bordit të Administrimit zgjat 3 vjet, me të drejte rimandatimi.

Bordi i Administrimit funksionon dhe merr vendime mbështetur në Rregulloren e përgatitur e miratuar prej tij dhe të aprovuar nga Presidenti i shoqërisë, pas pëlqimit të ortakëve.

### **Neni 11** **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Bordi i Administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe të edukimit;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori dhe drejtuesit e strukturave të edukimit.
- c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të lejojë për të vendosur për gjithçka që kërkohet nga rregullimet ligjore dhe nënligjore të fushës së edukimit, Senati Akademik të KUB.
- d) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- dh) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- ë) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimitarise, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori.
- f) të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë



në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, kur plotësohen kriteret ligjore.

g) të propozojë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

gj) të kryejë veprime të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Në rastet e parashikuara në ligj, Bordi i Administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

## **Neni 12** **ADMINISTRATORI**

Emërimi i Administratorit të shoqërisë është kompetencë e asamblesë së ortakëve. Administrator i shoqërisë emërohet Ardi Bezo. Mandati i administratorit zgjat 3 (tre) vjet dhe me të drejtë riemërimi.

- Administratori ka këto kompetenca:

a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;

b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatisi dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;

d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

e) të raportojë përpara asamblesë për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

f) administratori e administron shoqërinë sipas mënyrës dhe kompetencave që përcaktohen me vendim të mbledhjes së ortakëve.

## **Neni 13**

### **INVENTARI, PASQYRAT DHE VITI FINANCIAR**

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Në përfundim të çdo viti financiar, Administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së tatimeve dhe vlerës së fondit rezervë destinohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

## **Neni 14**

### **PRISHJA E SHOQËRISË**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

a) Kur mbaron periudha kohore për të cilën është themeluar;

b) Me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve;

c) Me hapjen e një procedure falimentimi;

d) Nëse nuk ka kryer aktivitet tregëtar për periudhën e përcaktuar në ligj;



- e) Me vendim të organeve kompetente - Gjykates;
- f) Për arsye të tjera në përputhje me ligjin.

**Neni 15**  
**LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e asamblesë së ortakëve, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim.  
Për këtë qëllim, Mbledhja e asamblesë së ortakëve do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar dispozitat e parashikuara në ligj.  
Mbledhja e asamblesë së ortakëve, emëron një apo më shumë likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

**Neni 16**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Të gjitha çështjet që nuk gjejnë një rregullim të posaçëm në këtë statut, në marrëveshje me palët, do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil në fuqi apo nga dispozitat e Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në fuqi dhe ligjit "Për Arsimin e Lartë në Shqipëri".  
Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të këtij STATUTI, si dhe midis Ortakëve të shoqërisë, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**Neni 17**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

Ky statut është redaktuar nga ortakët në 3 (tre) ekzemplarë me vlerë të njëjtë juridike në gjuhën shqipe.

Ky Statut është ndryshuar me Vendimin e Ortakëve nr.1 date 02.02.2018.

**ORTAKËT:**

1. Ylber BEZO
2. Nadire BEZO
3. Bledi BEZO
4. Ardi BEZO

*Ylber Bezo*  
*Nadire Bezo*  
*Bledi Bezo*  
*Ardi Bezo*

